

LIGJ
Nr.8390, datë 6.8.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 "PËR TARIFAT
DOGANORE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8182, DATË 23.12.1996**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh, anëtarë të Komisionit të Përhershëm të Industrisë, Punëve Publike, Transporteve dhe Tregtisë,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore", ndryshuar me ligjin nr.8182, datë 23.12.1996 tarifat doganore të importit për elementet e veçanta të telave të bakrit e të aluminit, ndryshohen si vijon:

		Tarifa në përqindje	
		Ishte	Bëhet
a) Kreu 7408. 11 Elementi "Tela bakri"			
(në të cilat dimensionin kryq maksimal			
i kalon 6 mm).....			
	20		5
b) Kreu 7605. 11 Elementi "Tela alumini" (në të cilat			
dimensionin maksimal transversal			
seksional i kalon 7 mm)			
	20		5

Neni 2

Ky ligj hyn në fyqi me dekretimin nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2187, datë 13.8.1998 të Presidentit të Republikë së Shqipërisë, Rexhep Meidani